



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës

www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 1952 Dt. 23 / 09 / 2024

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 pika 1.1.2., të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XVIII të mbajtur më datë 20.9.2024, mori këtë:

**VENDIM**

Dr.Sc. Vaxhid Sadriu zgjidhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët: E drejta e procedurës penale – Pjesa e posaçme, E drejta e krahasuar, Praktika profesionale, Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale, Etikë ligjore dhe profesionale dhe Psikologjia gjyqësore në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Zgjedhja është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 168, 169 dhe 172 të Statutit të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ Ref.nr. 01/1328 të datës 26.06.2024.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Universitetit.

Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Ligjin për pagat në sektorin publik Ligji Nr. 08/L-196 të datës 05.01.2023.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

**Arsyetim**

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan ka shpallur konkurs Ref.nr.01/1559 të dt.29.07.2024, për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik një mësimdhënës në Fakultetin Juridik për lëndët: E drejta e procedurës penale – Pjesa e posaçme. E drejta e krahasuar, Praktika profesionale. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në fushën penale. Etikë ligjore dhe profesionale dhe Psikologjia gjyqësore

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Dr.Sc. Vaxhid Sadriu, i plotëson kushtet për t'u zgjedh në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve sipas raportit Ref.nr. 05/1921 të datës 20.09.2024, vendosi që Dr. Sc. Vaxhid Sadriu të zgjidhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe, Komisionit për Ankesa dhe Parashtrësia të Senatit të Universitetit.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurës
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave



Prof. Assoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor  
Kryesues i Senatit